

**Letër e hapur
Kryetarit të Komunës së Prizrenit z. Ramadan Muja**

I nderuari z. Muja,

Fillimisht, dëshirojmë të jua urojmë mandatin e fituar, duke shpresuar që katër vitet e ardhshme do t'i shfrytëzoni për prosperitetin e komunës suaj dhe përmbushjen e premtimeve të dhëna, në bazë të të cilave qytetarët ju kanë dhënë besimin.

Instituti për Studime të Avancuara GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Huluntuuese (BIRN) kanë monitoruar aktivitetet dhe premtimet e juaja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2009. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në dy debatet e juaja të mbajtura në "Jeta në Kosovë", ju kemi premtuar:

- Investime prej 170 milionë Euro në katër vitet e ardhshme (prelim i Kryeministrit Thaçit për Prizrenin);
- Buxhet komunal për katër vitet e ardhshme në vlerë prej 160 milionë , ndër to vetëm rreth 62 milionë do të jenë për investime kapitale;
- Për fshatrat e rajonit të Hasit të Prizrenit (Lugishtë, Romajë dhe Gojan): rregullimin e të gjitha rrugëve dhe pajisjen e shkollave me ngrohje qendrore dhe me salla të sportit;
- Krijim të vende të reja të punës;
- Mirëqenie sa më të mirë për qytetarët e komunës;
- Përkrahje për shoqatat e dala nga lufta;
- Lirimin e zeztarëve të zejeve të rralla nga taksat komunale;
- Lirimin e investitorëve që do të hapin biznese dhe ulin papunësinë për dy vjet nga taksat komunale;
- Stimulimin e investimeve me anë të nxjerrjes më të lehtë të dokumentacioneve;
- Ulje të taksave dhe tatimeve për prizrenasit;
- Në lagjen "Jeta e Re": vazhdimin e investimeve në rregullimin e kushteve për të gjithë, ndërtimin e një salle të edukatës fizike, ndërtimin e një ambulance, asfaltimin dhe pajisjen me kanalizim të të gjitha rrugicave;
- Zhvillim të hovshëm ekonomik;
- Inkuadrimin e ekonomisë formale dhe jo formale;
- Ndërtimin e autostradës Vërmicë – Merdare;
- Ndërtimin e hidrocentralit të Zhurit;
- Punësimin e 3,500 qytetarëve në projekte që do të jenë investime të përbashkëta, me investitor të vendit dhe ndërkombëtarë;
- Zhvillim dhe modernizim të arsimit;
- Ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore;
- Përfshirjen e rinisë në të gjitha aktivitetet kulturore e sportive, në mënyrë që ajo të bëhet forcë kryesore dhe kreative për një zhvillim edhe më të madh ;
- Ruajtjen e trashëgimisë kulturore;
- Krijimin e sipërfaqeve të reja të gjelbra;
- Kushte më të mira për shkollim të mesëm dhe studime;

- Administratë të shpejtë dhe efikase;
- Ndryshime pozitive në infrastrukturë, rrugë dhe ujësjellës;
- Rregullimin e shtratit të lumit;
- Furnizimin e Prizrenit me ujë të pijshëm nga malet të Sharrit;
- Themelimin e Universitetit të Prizrenit;
- Krijimin e kushteve më të mira në arsim (në ndërtim e sipër janë 10 objekte shkollore, 5 objekte me buxhet të komunës, 5 me buxhetin e Ministrisë së Arsimit);
- Sigurimin e ujit të pijshëm prej Gurit të Zi (projekt me vlerë rreth 3 milionë euro);
- Projekti i gurrës së Poslishtës dhe gurrës së Vërmicës dhe ndërtimi i fabrikës për pastrimin dhe filtrimin e ujit;
- Ndërtimin e shtëpisë së djegur të Shaip Spahisë;
- Konservimin e shtëpisë së Musa Qezadës që do të shndërrohet në muze etnografik;
- Mbrojtjen e trashëgimisë (për katër vitet e ardhshme 6 mil euro e gjysmë);
- 84 hektarë tokë për zonën industrial dhe zonën për industri të lehtë;
- 20 mijë euro për festivalin e filmit “Dokufest” përkrahje për vitin 2010.

Për fund, ju bëjmë me dije se Instituti GAP dhe BIRN, në fund të çdo viti kalendarik, do të dalin me raporte vlerësuese rreth përmbushjes së premtimeve të dhëna nga kryetarët e komunave.

Ju urojmë qeverisje të suksesshme dhe shpresojmë në bashkëpunimin tuaj edhe në të ardhmen.

Sinqerisht,

Instituti për Studime të Avancuara GAP
Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)